



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 30.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **24.11.2023**, të parashtruar nga OE **HIDRO PROJECT SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i QKMF ne Istog” me Nr. të Prok: 206-23-6380-5-1-2 nxjerr:**

V E N D I M

1. **REFUZOHET**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE **HIDRO PROJECT SHPK** e dt. 24.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Ndërtimi i QKMF ne Istog”** me Nr. të Prok: **206-23-6380-5-1-2** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 20.11.2023.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 20.11.2023.
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik **HIDRO PROJECT SHPK** me datën 24.11.2023 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i QKMF ne Istog”** me Nr. prokurimi **206-23-6380-5-1-2**. Autoriteti Kontraktues, me datë 30.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Neni 1 i LPP-së Qëllimi

Neni 7 i LPP-së Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 33 i LPP-së Procedurat e hapura dhe të kufizuara

Neni 56 i LPP-së Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 i LPP-së Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 i LPP-së Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 8 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
Neni 72 i LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 47 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Autoriteti kontraktues/Ministria e Shëndetësisë me dt. 26.06.2023 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i QKMF në Istog, kontratë pune me vlerë të madhe dhe procedurë të kufizuar.

Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues për tenderues të kualifikuar/eliminuar është publikuar me dt. 20.11.2023 ku janë kualifikuar gjithsejtë pesë operator ekonomik (nuk është arritur maksimumi i lejuar prej 6 operatorëve ekonomik).

Grupi i operatorëve ekonomik Hidro Project Shpk dhe Engroup Shpk/përkatësisht ne jemi eliminuar nga gara e mëtutjeshme gjegjësisht nuk jemi kualifikuar më tutje për fazën tjetër.

Arsyeja e eliminimit të grupi tonë është si më poshtë:

Nuk e kemi prezantuar inxhinierin me certifikatë të efijencës së energjisë sipas kërkesës 3 të kapacitetit teknik dhe profesional në NjK dhe DT-nuk kemi ofruar asnjë dokument për dëshmi.

Sa i përket kësaj arsye të eliminimit, ju konfirmojmë se ne e plotësojmë këtë kërkesë plotësisht dhe këtë e argumentojmë me dëshmi konkrete.

Kërkesa Nr.3 tek neni 9.1&9.2 përkitazi me kapacitetin teknik dhe profesional ka qenë si më poshtë:

Kërkesa 3. Staf i profesional – Inxhinier ose Master – Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon me staf profesional të nevojshëm (min. 6 inxhinier) për realizimin e projektit.

Së paku njëri prej tyre të dëshmojë se ka udhëhequr punime në lëmin e efijencës së energjisë.

3.1 Një - Menaxher i Projektit – Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës ose Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, me përvojë 10 vjeçare profesionale në menaxhimin e projekteve ndërtimore.

3.2 Një Inxhinier kryesor i punishtes – Inxhinier i Operativës në teren –Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – Konstruktiv, së paku 5 vite përvojë profesionale në udhëheqjen e projekteve ndërtimore.

3.3 Një Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës, së paku 5 vite përvojë profesionale në fushën e ndërtimit.

3.4 Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – Hidroteknik, së paku 5 vite përvojë pune profesionale në fushën e ndërtimit.

3.5 Një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës, së paku 5 vite përvojë pune profesionale në fushën e ndërtimit.

3.6 Një Inxhinier i Diplomuar i Makinerisë, së paku 5 vite përvojë pune profesionale në fushën e ndërtimit.

Dëshmia dokumentare

Dëshmia 3. Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur - Certifikata për efijence të energjisë, për njërin nga inxhinierët e kërkuar.

Diplomat e noterizuar (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master), CV-t e nënshkruara nga vet inxhinieret, Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt, Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës, gjithashtu, për Menaxherin e projektit si dëshmi kërkohet - Vendim për caktimin e Menaxherit të projektit.

Pra dëshmi dokumentare është kërkuar që njëri nga inxhinierët të jetë i certifikuar për efizienzë të energjisë.


Ne si grup i operatorëve ekonomik “Hidro Project Shpk&Engroup Shpk me rastin e ofertimit gjegjësisht me dosje kemi bashkangjitur listën e stafit profesional të liderit Hidro Project në përbërje prej 8 inxhinierëve, e ku në numrin rendor 2 është inxhinierja znj.Arberesha Kastrati.

Për inxhinieren Arberesha Kastrati ne kemi bashkangjitur me dosje, Diplomën e masterit të noterizuar dhe kontratën e punës për projektin në fjalë, mirëpo tani e kemi vërejt se për shkak të një lëshimi teknik nuk kemi bashkangjitur certifikatën për auditim të energjisë në ndërtesa. Pra ka qenë një lëshim teknik nga ana jonë me rastin e bashkëngjitjes së dokumentacionit.

Këtë certifikatë e kemi bashkangjitur në projektin tjetër të zhvilluar nga ana juaj “Ndërtimi i QKMF në Drenas” dhe këtë mund ta vërtetoni nëse analizoni dokumentet tona në këtë tender (si dëshmi që ka ekzistuar kjo certifikatë para datës së fundit të dorëzimit të aplikacioneve).

Si dëshmi se inxhinierja Arberesha Kastrati ka certifikatën për auditim të energjisë në ndërtesa, po ju bashkëngjisim me këtë kërkesë për rishqyrtim certifikatën e trajnimit. Certifikata në fjalë mban datën para datës së hapjes së ofertave, konkretisht trajnimi nga inxhinierja në fjalë është mbajtur nga 28 shtator deri me dt.09.12.2020.

Ju si autoritet kontraktues është dashur të veproni në harmoni me nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe në harmoni me nenin 8 të Rregullores Nr.001/2022 Për prokurim publik dhe të kërkonit sqarime shitesë në lidhje me mungesën e certifikatës së inxhinieres Arberesha Kastrati.



CERTIFIKATË

Arberesha Kastrati

Përfundoj me sukses trajnimin për Auditor lidhur me

Auditimin e energjisë në ndërtesa

në Prishtinë, në periudhën 28 Shtator deri më 09 dhjetor 2020

Trajnimi është financuar nga Qeveria Gjermane nëpërmjet Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Meqenëse nuk janë zbatuar dispozitat e lartpërmendura me rastin e vlerësimit të aplikacioneve atëherë me mirëkuptim kërkohet nga ana juaj që të merret parasysh certifikata e trajnimit për auditim të energjisë në ndërtesa e znj. Arberesha Kastrati. Kjo certifikatë duhet të merret parasysh sepse i plotëson kushtet sipas nenit 72.3 të LPP-së, pasi që mund të vërtetohet në mënyrë objektive ekzistenca e saj.

Nenin 72 i LPP-së:

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës”.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Certifikata në fjalë, bënë pjesë në kuadër të dëshmimeve prej nenit 65-71, ku lejohen të kërkojnë sqarime dhe plotësime, konkretisht certifikata bënë pjesë në kuadër të kualifikimeve shkollore dhe profesionale në kuadër të nenit 69 të LPP-së, prandaj sipas këtyre dispozitave është dashur të kërkojnë sqarime dhe plotësime në lidhje me këto dëshmi.

Po ashtu neni 59.2 i LPP-së parasheh si më poshtë:

“Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve Pra, të gjitha këto dispozita ligjore lejojnë dhe parashohin mundësinë e sqarimeve dhe plotësimeve të dokumenteve të munguara, prandaj edhe ju si autoritet kontraktues është dashur të veproni në këtë mënyrë.

Natyrisht që këto dispozita duhet të përdoren në harmoni edhe me nenin 7 të LPP-së përkitazi me trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomik.

Nga prezantimi i dëshmisë/përkatësisht certifikatës së inxhinieres Arberesha Kastrati, vijmë në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i aplikacioneve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, si dhe nuk janë zbatuar dispozitat e nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, prandaj me mirëkuptim kërkohet që të zbatohen këto dispozita me rastin e rishqyrtimit të kësaj kërkesë për rishqyrtim dhe të kualifikohemi në fazën tjetër.

Duke marr për bazë të gjitha sqarimet dhe dëshmitë konkrete vijë në përfundim se nuk është respektuar edhe dispozita e nenit 47 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik sepse nuk jemi kualifikuar për fazën tjetër edhe pse i kemi i plotësuar të gjitha kërkesat e fletës së të dhënave për para kualifikim të dokumentit para kualifikues.

Neni 56.2.2 e përcakton qartë se numri maksimal i kandidatëve të para kualifikuar është 6, prandaj në këtë rast është edhe një vend i zbrazët për tu plotësuar numri maksimal prej 6 kandidatëve.

Po ashtu neni 47.17. i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik e përcakton që numri maksimal i kandidatëve të para kualifikuar është 6, kurse në njoftimin mbi vendimin shihet se janë para kualifikuar pesë operator ekonomik, e që domethënë për tu arritur numri maksimal i tenderuesve të para kualifikuar mund të përfshihet edhe një tenderues, e në këtë rast ne i plotësojmë të gjithë kërkesat e përshtatshmërisë dhe kërkesat minimale për kualifikim, prandaj duhet të jemi tenderuesi i 6 i kualifikuar në këtë rast.

Njëkohësisht nuk është marr në konsideratë edhe neni 7 i LPP-së, pasi që paragrafi 1 i këtij neni e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Konsiderojmë se ne jemi diskriminuar në këtë fazë parakualifikuese, prandaj kërkojmë që të respektohen të gjitha dispozitat e LPP-së dhe të merret parasysh certifikata e trajnimit për auditim të energjisë në ndërtesa e znj. Arberesha Kastrati.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin ankimore te OE ankues:

Nuk qendron pretendimi juaj rreth inxhinieres znj. Arberesha Kastrati, meqense certifikata për efijencë te energjisë, ka qene qartë e specifikuara ne NJK dhe DT, kërkesa 3 te Kapaciteti teknik dhe profesional, dhe si e tille është dashtë te plotësohet nga secili ofertues ose GOE, ju nuk e keni ofruar ne ofertën tuaj.

Gjithashtu per znj. Arberesha Kastrati ne oferten tuaj mungon edhe CV e inxhinieres, e kërkuar për ta dëshmuar përvojën 5 vjeçare qe është kërkuar ne NJK dhe DT.

Sa i përket njoftimit tuaj se këtë certifikatë e keni bashkangjitur në projektin tjetër të zhvilluar nga MSh, ne nuk e kemi vërejtur një gjë te tille, ajo mund ta vërtetohet, por secili projekt trajtohet ndaras.

Ne lidhje me oferten tuaj ka paraqitur pretendime edhe OE tjeter ankues, prej te cilave vlen te theksohet se inxh. i Makinerise i ofertes tuaj z. Ramadan Gashi, diplomen si master e ka me 16.01.2020 dhe nuk e ka eksperiencen e kërkuar prej 5 vite përvoje pune pas diplomimit, siç është kërkuar ne NJK dhe DT. Gjithashtu nga OE tjeter ankues janë evidentuar mangesi edhe te pajisjet e kërkuara sipas kriterit nr. 5 te NJK dhe DT.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit